

32002L0013

Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 mars 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jo-jetë

Gazeta Zyrtare L 077, 20/03/2002 fq. 0017-0022

Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 5 mars 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin e aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jo-jetë

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 47 paragrafi 2 dhe nenin 55 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2),

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit (3),

Meqë:

(1) Plani i veprimit për shërbimet financiare, siç u miratua nga mbledhjet e Këshillit Europian në Këln, më datat 3 dhe 4 qershor 1999, dhe në Lisbonë, më datat 23 dhe 24 mars 2000, njih rëndësinë e nivelit të aftësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve për të mbrojtur policëmbajtësit në tregun e brendshëm duke siguruar që ndërmarrjet e sigurimeve të kenë kërkesa për mjaftueshmërinë e kapitalit në lidhje me natyrën e risqeve të tyre.

(2) Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (4) kërkon që ndërmarrjet e sigurimeve të kenë nivel të aftësisë paguese.

(3) Kërkesa që ndërmarrjet e sigurimeve të krijojnë, mbi provigjonet teknike për përmbushjen e pasiveve të marrjes në sigurim, një nivel të aftësisë paguese për të vepruar si mbrojtje ndaj luhatjeve negative të veprimtarisë, është një element i rëndësishëm në sistemin e mbikëqyrjes për mbrojtjen e personave të siguruar dhe policëmbajtësve.

(4) Rregullat ekzistuese për nivelin e aftësisë paguese të vendosura nga Direktiva 73.239/KEE kanë mbetur në thelb të pandryshuara nga legjislacioni i mëvonshëm i Komunitetit, ndërsa Direktiva e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (direktiva e tretë e sigurimeve jo-jetë)(5) i kërkonte Komisionit të paraqiste një raport Komitetit të Sigurimeve të ngritur me Direktivën e Këshillit 91/675/KEE (6), për nevojën për harmonizim të mëtejshëm të nivelit të aftësisë paguese.

(5) Komisioni e ka përgatitur këtë raport nën dritën e rekomandimeve të raportit mbi aftësinë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve të përgatitur nga Konferenca e Autoriteteve Mbikëqyrëse të Sigurimeve të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

(6) Edhe pse raporti nxori përfundimin që natyra e thjeshtë dhe e qëndrueshme e sistemit tanishëm ka funksionuar në mënyrë të pranueshme dhe bazohet në parime të shëndosha që përfitojnë nga transparenca e gjerë, janë identifikuar disa dobësi të caktuara në raste të veçanta, veçanërisht për profilet e ndjeshme të risqeve.

(7) Nevojitet thjeshtëzimi dhe rritja e fondeve ekzistuese për garancinë minimale, veçanërisht si rezultat i inflacionit të niveleve të kërkesave për dëmshpërblim dhe shpenzimeve operative qysh nga miratimi i tyre fillestar. Në bazë të kësaj, është mirë të rriten pragjet përtej të cilave norma më e ulët e përqindjes zbatohet për përcaktimin e kërkesës për nivelin e aftësisë paguese mbi bazën e primeve dhe kërkesave për dëmshpërblim.

(8) Për mënjanimin e rritjeve të konsiderueshme dhe të menjëhershme të shumës së fondeve të garancisë minimale dhe pragjeve minimale në të ardhmen, është mirë të krijohet një mekanizëm që parashikon rritjen në përputhje me indeksin europian të çmimeve të konsumit.

(9) Në situata të veçanta ku rrezikohen të drejtat e policëmbajtësve, është e nevojshme që autoritetet kompetente të kenë kompetencë të ndërhyjnë në një fazë mjaftueshmërisht të hershme, por në ushtrim të këtyre kompetencave, autoritetet kompetente është mirë t'i informojnë ndërmarrjet e sigurimeve për arsyet që motivojnë këtë veprim mbikëqyrës, në përputhje me parimet e administrimit të shëndoshtë dhe në zbatim të drejtë të ligjit. Për sa kohë që vazhdon një situatë e tillë, nuk është mirë të lejohen autoritetet kompetente të certifikojnë që ndërmarrja e sigurimeve ka një nivel të mjaftueshëm të aftësisë paguese.

(10) Në dritën e zhvillimeve të tregut sa i takon natyrës së mbulimit me risigurim të blerë nga siguruesit parësorë, është e nevojshme që autoritetet kompetente të kenë kompetencë të kufizojnë në rrethana të caktuara zvogëlimin e kërkesës për nivelin e aftësisë paguese.

(11) Nëse siguruesi e redukton në masë të konsiderueshme ose e ndërpret lidhjen e kontratave të reja, është e nevojshme të vendoset një nivel i mjaftueshëm i aftësisë paguese në lidhje me detyrimet e mbetura për veprimtarinë ekzistuese që reflektohet në nivelin e provigjoneve teknike.

(12) Për klasa të veçanta të veprimtarisë jo-jetë që i nënshtrohen një profili risku tepër të paqëndrueshëm, kërkesa ekzistuese për nivelin e aftësisë paguese është mirë të rritet ndjeshëm në mënyrë që niveli i kërkuar i aftësisë paguese të përputhet më mirë me profilin e riskut të veprimtarisë.

(13) Për të reflektuar ndikimin e qasjeve të ndryshme kontabël dhe aktuariale, është e përshtatshme të bëhen rregullimet përkatëse në metodologjinë për llogaritjen e kërkesës për nivelin e aftësisë paguese në mënyrë që kjo të llogaritet në mënyrë koherente dhe të njëtrajtshme, duke i vendosur ndërmarrjet e sigurimeve në pozita të barabarta.

(14) Kjo direktivë duhet të vendosë standardet minimale për kërkesat për nivelin e aftësisë paguese dhe është mirë që Shtetet Anëtare të origjinës të jenë në gjendje të vendosin rregulla më të shtrënguara për ndërmarrjet e sigurimeve nga autoritetet e tyre kompetente.

(15) Duhet ndryshuar Direktiva 73/239/KE përkatësisht,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Shtesa dhe ndryshime në Direktivën 73/239/KEE

Direktiva 73/239/KE ndryshohet si vijon:

1. Neni 3, pika 1 zëvendësohet si më poshtë: "1. Kjo direktivë nuk zbatohet për shoqatat e përbashkëta që përmbushin kushtet e mëposhtme:

(a) statuti duhet të përmbajë dispozita për të kërkuar kontribute shtesë ose për të zvogëluar përfitimet;

(b) veprimtaria e tyre nuk mbulon risqet e përgjegjësisë, përveç se kur këto përmbajnë një mbulim ndihmës brenda kuptimit të pikës C të shtojcës, ose të risqeve të kredisë dhe garancisë;

(c) të ardhurat nga kontributet vjetore për veprimtaritë e mbuluara nga kjo direktivë nuk duhet të tejkalojnë 5 milion Euro dhe;

(d) të paktën një e dyta e të ardhurave nga kontributet nga veprimtaritë e mbuluara nga kjo direktivë duhet të vijnë nga personat që janë anëtarë të shoqatës së përbashkët.

Kjo direktivë nuk zbatohet për ndërmarrjet që përmbushin kushtet e mëposhtme:

- ndërmarrja nuk ndjek asnjë veprimtari që përfshihet në fushën e veprimit të kësaj direktive me përjashtim të atyre që përshkruhen në klasën 18 në pikën A të shtojcës,

- kjo veprimtari ushtrohet vetëm në mënyrë lokale dhe përbëhet vetëm nga përfitime në natyrë dhe

- të ardhurat e përgjithshme vjetore të arkëtuara në lidhje me veprimtaritë e asistencës për personat që hasin vështirësi nuk i kalojnë 200000 Euro.

Megjithatë, dispozitat e këtij neni nuk e pengojnë ndërmarrjen e përbashkët të sigurimeve të kërkojë të licencohet, ose të vazhdojë të jetë e licencuar, sipas kësaj direktive;"

2. Neni 16 zëvendësohet si më poshtë: "Neni 16

1. Secili Shtet Anëtar i kërkon çdo ndërmarrjeje të sigurimeve me zyra qendrore në territorin e tij, një nivel të mjaftueshëm të aftësisë paguese të disponueshme në lidhje me të gjithë veprimtarinë, i cili të jetë të paktën i barabartë me kërkesat e kësaj direktive.

2. Niveli i aftësisë paguese në dispozicion përbëhet nga të gjitha aktivet e ndërmarrjes së sigurimeve të lira nga çdo detyrim i parashikuar, pasi u janë zbritur zëra jomateriale, duke përfshirë:

(a) kapitalin aksionar të parapaguar ose, në rastin e një ndërmarrjeje të përbashkët sigurimesh, fondin faktik themeltar plus llogaritë e anëtarëve që përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:

(i) akti i themelimit dhe statuti duhet të parashikojnë që pagesat mund të bëhen nga këto llogari për anëtarët vetëm për atë që kjo nuk bën që niveli i aftësisë paguese i disponueshëm të bjerë poshtë nivelit të kërkuar ose, nëse, pas prishjes së ndërmarrjes, të jenë paguar të gjitha borxhet e tjera të ndërmarrjes;

(ii) akti i themelimit dhe statuti duhet të parashikojnë që, në lidhje me çdo pagesë të përmendur në nënpikën (i) për shkaqe që nuk përfshijnë ndërprerjen individuale të anëtarësisë, autoritetet

kompetente duhet të njoftohen të paktën një muaj paraprakisht dhe brenda asaj periudhe mund të ndalojnë pagesën;

(iii) dispozitat përkatëse të aktit të themelimit dhe statutit mund të ndryshohen vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë deklaruar që nuk kanë kundërshtim për ndryshimin, pa cenuar kriteret e shprehura në nënpikat (i) dhe (ii);

(b) rezervat (ligjore dhe të lira) që nuk përkojnë me përgjegjësitë e kontraktuara;

(c) fitimi ose humbja e mbartur pas zbritjes së dividendëve që duhet të paguhet.

Nivelit të aftësisë paguese të disponueshëm i zbritet shuma e aksioneve të veta që mbahen drejtpërdrejt nga ndërmarrja e sigurimeve.

Për ato ndërmarrje sigurimesh të cilat i skontojnë ose i zvogëlojnë provigjionet teknike për dëmet pezull për të marrë parasysh të ardhurat nga investimet sipas parashikimit në nenin 60 pika 1 germa “g” të Direktivës së Këshillit 91/674/KEE, datë 19 dhjetor 1991, për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjeve të sigurimeve (7), nivelit të aftësisë paguese në dispozicion i zbritet diferenca ndërmjet provigjioneve teknike të paskontuara ose provigjioneve teknike para zbritjeve, siç pasqyrohen në shënimet shpjeguese të llogarive, dhe provigjioneve të skontuara ose teknike pas zbritjeve. Ky rregullim bëhet për të gjitha risqet e renditura në pikën A të shtojcës, përveç risqeve të renditura në klasat 1 dhe 2. Për klasat që nuk janë klasat 1 dhe 2, nuk është e nevojshme të bëhet asnjë rregullim në lidhje me skontimin e anuiteteve të përfshira në provigjionet teknike.

3. Niveli i aftësisë paguese në dispozicion mund të përbëhet edhe nga:

(a) kapitali i aksioneve progresive me përparësi dhe kapitali i borxhit të varur deri në 50% të shumës më të vogël të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe nivelit të kërkuar të aftësisë paguese, ku jo më shumë se 25% e së cilit përbëhet nga hua të varura me maturim fiks ose nga kapital i aksioneve progresive me përparësi me afat fiks, me kusht që në rastin e falimentimit ose likuidimit të ndërmarrjes së sigurimeve, të ekzistojnë marrëveshje detyruese sipas të cilave kapitali i borxhit të varur ose kapitali i aksioneve me përparësi të renditet pas pretendimeve të të gjithë kreditorëve të tjerë dhe nuk duhet të shlyhet pa u shlyer të gjitha borxhet pezull në atë moment.

Kapitali i borxhit të varur duhet të përmbushë edhe kushtet e mëposhtme:

(i) mund të merren parasysh vetëm fondet e parapaguara plotësisht;

(ii) për huatë me një maturim me afat fiks, maturimi fillestar duhet të jetë të paktën pesë vjet. Jo më vonë se një vit para datës së shlyerjes ndërmarrja e sigurimeve duhet t'u paraqesë autoriteteve kompetente për miratim një plan i cili tregon si do të mbahet niveli i disponueshëm i aftësisë paguese ose si do të sillet në nivelin e kërkuar në kohën e maturimit, përveç kur masa në të cilën huaja mund të renditet si një pjesë përbërëse e nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese të zvogëlohet gradualisht gjatë, të paktën, pesë viteve të fundit para datës së shlyerjes. Autoritetet kompetente mund të autorizojnë shlyerjen e parakohshme të këtyre huave, me kusht që kërkesa të jetë bërë nga ndërmarrja e sigurimeve dhënëse dhe niveli i saj i disponueshëm i aftësisë paguese të mos bjerë poshtë nivelit të kërkuar;

(iii) huatë, maturimi i të cilave nuk është i caktuar, duhet të jenë të shlyeshme vetëm duke iu nënshtruar njoftimit pesëvjeçar, me përjashtim të rastit kur huatë nuk vazhdojnë të konsiderohen si pjesë përbërëse e nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese, ose të rastit kur pëlqimi paraprak i

autoriteteve kompetente kërkohet shprehimisht për shlyerjen e parakohshme. Në rastin e fundit, ndërmarrja e sigurimeve duhet të njoftojë autoritetet kompetente të paktën gjashtë muaj para datës së shlyerjes së propozuar, duke specifikuar nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese para dhe pas shlyerjes. Autoritetet kompetente e autorizojnë shlyerjen vetëm nëse niveli i disponueshëm i aftësisë paguese të ndërmarrjes së sigurimeve nuk bie poshtë nivelit të kërkuar;

(iv) marrëveshja e huasë nuk duhet të përfshijë asnjë dispozitë kontrate që të parashikojë që në rrethana të caktuara borxhi bëhet i shlyeshëm para datave të rena dakord për shlyerjen, përveç rastit të likuidimit të ndërmarrjes së sigurimeve;

(v) marrëveshja e huasë mund të ndryshohet vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë deklaruar që ata nuk kanë asnjë kundërshtim për ndryshimin;

(b) letrat me vlerë që nuk kanë datë të specifikuar maturimi dhe instrumentet e tjerë, duke përfshirë aksionet preferencialë kumulativë të ndryshëm nga ata që përmenden në pikën (a), deri në 50% të shumës më të vogël të marshit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe të nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për totalin e këtyre letrave me vlerë dhe kapitali i borxhit të varur të përmendura në pikën (a), me kusht që ato të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

(i) ato nuk mund të shlyhen me iniciativën e zotëruesit ose pa pëlqimin paraprak të autoritetit kompetent;

(ii) kontrata e emetimit duhet t'i japë mundësi ndërmarrjes së sigurimeve të shtyjë pagesën e interesit mbi huanë;

(iii) pretendimet e huadhënësit për ndërmarrjen e sigurimeve duhet të renditen tërësisht pas të gjithë kreditorëve jo të nënrenditur;

(iv) dokumentet që rregullojnë emetimin e letrave me vlerë duhet të parashikojnë aftësinë e thithjes së humbjeve nga borxhet dhe të interesit të papaguar, duke i dhënë mundësi ndërmarrjes së sigurimeve të vazhdojë aktivitetin;

(v) mund të merren parasysh vetëm shumat e paguara plotësisht;

4. Me kërkesë të shoqëruar me dokumente mbështetëse të ndërmarrjes drejtuar autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës dhe me pëlqimin e autoritetit kompetent, niveli i disponueshëm i aftësisë paguese mund të përbëhet nga:

(a) një e dyta e kapitalit aksionar të papaguar ose fondit fillestar të papaguar, nëse pjesa e papaguar arrin në 25% të këtij kapitali aksionar ose fondi, deri në 50% të shumës më të vogël të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe të nivelit të kërkuar të aftësisë paguese;

(b) në rastin e shoqatës së përbashkët ose llojeve të ngjashme tipa të shoqatave të përbashkta me kontribute të ndryshueshme, çdo pretendim që ajo ka kundrejt anëtarëve të saj nëpërmjet kërkimit të një kontributi shtesë, brenda vitit financiar, deri në gjysmën e diferencës ndërmjet kontributeve maksimale dhe kontributeve të kërkuara faktikisht dhe deri në një limit prej 50% të shumës më të vogël të nivelit të disponueshëm të aftësisë paguese dhe nivelit të kërkuar të aftësisë paguese. Autoritetet kompetente kombëtare vendosin orientime që caktojnë kushtet në të cilat mund të pranohen kontributet shtesë

(c) çdo rezervë neto e fshehur që rrjedh nga vlerësimi i sendeve pasurore, në masën që këto rezerva neto të fshehura nuk janë të një natyre të veçantë.

5. Ndryshimet e paragrafëve 2, 3 dhe 4, të cilat marrin parasysh zhvillimet që justifikojnë një rregullim teknik të elementëve të përshtatshëm për nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese, miratohen në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 2 të Direktivës së këshillit 91/675/KEE(8).";

3. Shtohet neni i mëposhtëm: "Neni 16a

1. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese përcaktohet në bazë të shumës vjetore të primeve ose kontributeve ose të barrës mesatare të dëmeve për të tre vitet e fundit financiare.

Megjithatë, në rastin e ndërmarrjeve të sigurimeve që sigurojnë në thelb vetëm një ose më shumë prej risqeve të kredisë, stuhisë, breshërit ose ngricës, për barrën mesatare të dëmeve merren si periudhë referuese shtatë vitet e fundit financiare.

2. Në përputhje me nenin 17, shumën e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese është e barabartë me shumën më të madhe të dy rezultateve sipas parashikimit në paragrafët 3 dhe 4.

3. Baza e primeve llogaritet duke përdorur shumën më të madhe të primeve ose kontributeve të shkruara bruto siç llogariten më poshtë dhe primeve ose kontributeve bruto të fituara.

Primet ose kontributet në lidhje me klasat 11, 12 dhe 13 të renditura në pikën A të shtojcës rriten me 50%.

Primet ose kontributet (duke përfshirë detyrimet shtesë për primet ose kontributet) të kërkueshme në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë në vitin e fundit financiar mblidhen së bashku.

Kësaj shume i shtohet shumën e primeve të pranuar për të gjithë risigurimin në vitin e fundit financiar.

Nga kjo shumë zbritet shumën e përgjithshme e primeve ose kontributeve të anuluar në vitin e fundit financiar, si dhe shumën e përgjithshme e tatimeve dhe detyrimeve që u takon primeve ose kontributeve që futen në këtë shumë.

Shumën e përftuar në këtë mënyrë ndahet në dy pjesë, ku pjesa e parë është deri në 50 milion Euro, pjesa e dytë përbëhet nga pjesa e mbetur; llogariten përkatësisht 18% dhe 16% e këtyre pjesëve dhe mblidhen bashkë.

Shumën e përftuar në këtë mënyrë shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve të fundit financiarë ndërmjet shumës së pretendimeve që mbetet të mbulohet nga ndërmarrja pas zbritjes së shumave të rikuperueshme sipas risigurimit dhe shumës bruto të pretendimeve; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më pak se 50%.

Me miratimin e autoriteteve kompetente, metodat statistikore mund të përdoren për të caktuar primet ose kontributet në lidhje me klasat 11, 12 dhe 13.

4. Baza e pretendimeve llogaritet si më poshtë, duke përdorur, në lidhje me klasat 11, 12, dhe 13 të renditura në pikën A të shtojcës, pretendimet, rezervat dhe rimarrjet të rritura me 50%.

Shumat e kërkesave për dëmshpërblim të paguara në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë (pa zbritur kërkesat për dëmshpërblim të mbuluara nga risiguruesit dhe retroceduesit) në periudhat e përcaktuara në pikën 1 mblidhen bashkë.

Kësaj shume i shtohet shuma e dëmeve të paguara në lidhje me risigurimet ose retrocedimet e pranuar gjatë të njëjtave periudha dhe shuma e provigjoneve për kërkesat për dëmshpërblim pezull të krijuara në fund të vitit të fundit financiar për aktivitetin e drejtpërdrejtë dhe për pranimet në risigurim.

Kësaj shume i zbritet shuma e rimarrjeve të realizuara gjatë periudhave të specifikuar në paragrafin 1.

Shumës së mbetur i zbritet shuma e provigjoneve për kërkesat për dëmshpërblim pezull të krijuara në fillimin e vitit të dytë financiar që është para vitit të fundit financiar për të cilin ka llogari, për veprimtarinë e drejtpërdrejtë dhe për pranimet në risigurim. Nëse periudha referuese e vendosur në pikën 1 është e barabartë me shtatë vjet, zbritet shuma e provigjoneve për kërkesat për dëmshpërblim pezull të krijuara në fillim të vitit të gjashtë financiar që është para vitit të fundit financiar për të cilin ka llogari.

Një e treta ose një e shtata e shumës së përftuar në këtë mënyrë, sipas periudhës së referencës së vendosur në pikën 1, ndahet në dy pjesë, ku pjesa e parë është deri në 35 milion Euro, pjesa e dytë përbëhet nga pjesa e mbetur; llogariten përkatësisht 26 % dhe 23 % e këtyre pjesëve dhe mblidhen bashkë.

Shuma e përftuar në këtë mënyrë shumëzohet me raportin që ekziston në lidhje me shumën e tre viteve të fundit financiarë ndërmjet shumës së pretendimeve që mbetet të mbulohet nga ndërmarrja pas zbritjes së shumave të rikuperueshme sipas risigurimit dhe shumës bruto të pretendimeve; ky raport nuk mund të jetë në asnjë rast më pak se 50%.

Me miratimin e autoriteteve kompetente, metodat statistikore mund të përdoren për të caktuar primet, provigjoneve dhe rimarrjet në lidhje me klasat 11, 12 dhe 13. Në rastin e risqeve të renditura në klasën 18 të pikës A të shtojcës, shuma e dëmeve të paguara që përdoret për të llogaritur bazën e dëmeve është kostoja që mbulohet nga ndërmarrja e sigurimeve në lidhje me asistencën e dhënë. Këto shpenzime llogariten në përputhje me dispozitat kombëtare të Shtetit Anëtar të origjinës.

5. Nëse niveli i kërkuar i aftësisë paguese i llogaritur në pikat 2, 3 dhe 4 është më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese i vitit të mëparshëm, niveli i kërkuar i aftësisë paguese është të paktën i barabartë me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të vitit të mëparshëm i shumëzuar me raportin e shumës së provigjoneve teknike për kërkesat për dëmshpërblim pezull në fundit të vitit financiar dhe shumës së provigjoneve teknike për kërkesat për dëmshpërblim pezull në fillim të vitit të fundit financiar. Provigjonet teknike në këto llogaritje llogariten pa risigurim, por raporti në asnjë rast nuk mund të jetë më i lartë se 1.

6. Koeficientët e zbatueshëm për pjesët e përmendura në paragrafin e gjashtë të pikës 3 dhe paragrafin e gjashtë të pikës 4 zvogëlohen me një të tretën në rastin e sigurimit shëndetësor të ushtruar me të njëjtën bazë teknike si sigurimi i jetës, nëse

(a) primet e paguara llogariten mbi bazën e tabelave të probabilitetit sipas metodës matematikore të zbatuar në sigurime;

(b) krijohet një provigjon për rritjen e moshës;

- (c) mblidhet një prim shtesë me qëllim që të krijohet një nivel sigurie në një shumë të përshtatshme;
- (d) ndërmarrja e sigurimeve mund të anulohet kontratën jo më vonë se para fundit të vitit të tretë të sigurimeve;
- (e) kontrata parashikon mundësinë e rritjes së primeve ose uljes së pagesave edhe për kontratat në vazhdim;

4. Neni 17 zëvendësohet si më poshtë: "Neni 17

1. Një e treta e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese sipas parashikimit në nenin 16a përbën fondin e garancisë. Ky fond përbëhet nga zërat e renditura në nenin 16 pikat 2, 3 dhe, me pëlqimin e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar të origjinës, edhe pika 4 germa "c".

2. Fondi i garancisë nuk mund të jetë më pak se 2 milion Euro. Megjithatë, nëse mbulohen të gjithë apo disa prej risqeve të përfshirë në klasat 10 deri 15 të renditura në pikën A të shtojcës, ai është 3 milion Euro.

Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë një zbritje prej një të katërtën të fondit minimal të garancisë të shoqatave të përbashkëta dhe shoqatave të ngjashme me to";

5. Shtohet neni i mëposhtëm: "Neni 17a"

1. Shumat në Euro sipas parashikimit në nenin 16a pika 3 dhe 4 dhe nenin 17 pika 2 rishikohen çdo vit duke filluar nga data 20 shtator 2003 me qëllim që të merren parasysh ndryshimet në indeksin europian të çmimeve të konsumatorit që përfshin të gjitha Shtetet Anëtare siç publikohet nga Eurostati.

Shumat përshtaten automatikisht duke rritur shumën bazë në Euro me ndryshimin në përqindje në atë indeks për periudhën ndërmjet hyrjes në fuqi të kësaj direktive dhe datës së rishikimit dhe të rrumbullakosur deri në një shumëfish të 100000 Euro.

Nëse ndryshimi në përqindje qysh nga përshtatja e fundit është më pak se 5% nuk bëhet asnjë përshtatje.

2. Komisioni informon çdo vit Parlamentin Europian dhe Këshillin për rishikimin dhe shumat e përshtatura të përmendura në pikën 1;";

6. teksti "neni 16 pika 3" në nenin 20 pika 2 zëvendësohet me tekstin "neni 16a";

7. Shtohet neni i mëposhtëm: "Neni 20a

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente kanë kompetencën të kërkojnë një plan të rimëkëmbjes financiare për këto ndërmarrje sigurimesh nëse autoritetet kompetente gjykojnë që rrezikohen të drejtat e policëmbajtësve. Plani i rimëkëmbjes financiare minimalisht përfshin hollësi ose prova në lidhje me të tre vitet financiarë pasues:

(a) për çmuarjet për shpenzimet e administrimit, veçanërisht shpenzimet e përgjithshme rrjedhëse dhe komisionet;

(b) një plan që parashikon vlerësime të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me veprimtarinë e drejtpërdrejtë, pranimet në risigurim dhe cedime risigurimesh;

(c) një parashikim bilanci;

(d) çmuarjet e burimeve financiare të parashikuara për të mbuluar pasivet e marrjes në sigurim dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;

(e) politikën e përgjithshme të risigurimeve.

2. Nëse të drejtat e policëmbajtësve rrezikohen për shkak se gjendja financiare e ndërmarrjes po përkeqësohet, Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente kanë kompetencën të detyrojnë ndërmarrjen e sigurimeve të ketë një nivel më të lartë të kërkuar të aftësisë paguese, me qëllim që të sigurojnë që ndërmarrja e sigurimeve është në gjendje të përmbushë kërkesat e aftësisë paguese në të ardhmen e afërt. Niveli më i lartë i kërkuar i aftësisë paguese bazohet në planin e rimëkëmbjes financiare të përmendur në pikën 1.

3. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën të zhvlerësojnë të gjithë elementët e lejuar për nivelin e disponueshëm të aftësisë paguese, veçanërisht, nëse ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në vlerën e tregut të këtyre elementëve qysh nga fundi i vitit të fundit financiar.

4. Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë kompetencën të kufizojnë zbritjen në nivelin e aftësisë paguese sipas parashikimit në përputhje me nenin 16a, bazuar në risigurim, nëse:

(a) natyra ose cilësia e kontratave të risigurimit ka ndryshuar në masë të konsiderueshme qysh nga viti i fundit financiar;

(b) nuk ka transferim ose ka një transferim të pakonsiderueshëm të riskut sipas kontratave të risigurimit.

5. Nëse autoritetet kompetente kanë kërkuar një plan të rimëkëmbjes financiare për ndërmarrjen e sigurimeve në përputhje me pikën 1, ato nuk lëshojnë një certifikatë financiare në përputhje me nenin 10 pika 3, paragrafin e dytë, të kësaj Direktive, nenin 16 pika 1 germa "a" të Direktivës së Këshillit 88/357/KEE (Direktiva e dytë për sigurimin jo-jetë) (9) dhe nenin 12 pika 2 të Direktivës së Këshillit 92/49/KEE (direktiva e tretë e sigurimit jo-jetë) (10), nëse ato konsiderojnë që të drejtat e policëmbajtësve rrezikohen sipas kuptimit të pikës 1."

Neni 2

Periudha kalimtare

1. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë ndërmarrjeve të sigurimeve që në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj direktive ofrojnë sigurime në territoret e tyre në një ose më shumë klasa të përmendura në Shtojcën e Direktivës 73/239/KEE, një periudhë prej pesë vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj direktive, me qëllim që të respektohen kërkesat e parashikuara në nenin 1 të kësaj direktive.

2. Shtetet Anëtare mund t'u lejojnë ndërmarrjeve të përmendura në pikën 1, të cilat pas mbarimit të periudhës pesëvjeçare nuk e kanë vendosur akoma nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, një periudhë tjetër që nuk i kalon dy vjet, për ta bërë këtë, me kusht që këto ndërmarrje, në përputhje me nenin 20 të Direktivës 73/239/KEE, të kenë paraqitur për aprovimin e autoriteteve kompetente masat që propozojnë të marrin për këtë qëllim.

Neni 3

Transpozimi

1. Shtetet Anëtare miratojnë jo më vonë se data 20 shtator 2003 aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të nevojshme për zbatimin e kësaj direktive. Shtetet Anëtare njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Shtetet Anëtare, në rastet kur miratojnë këto masa, përfshijnë një tekst referues që bën lidhjen me këtë direktivë ose i shoqërojnë ato me një tekst të tillë referues kur t'i botojnë zyrtarisht Mënyrat e përfshirjes së një teksti të tillë referues përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare parashikojnë që masat e përmendura në pikën 1 zbatohen fillimisht për mbikëqyrjen e llogarive për vitet financiare që fillojnë më 1 janar 2004 ose gjatë atij viti kalendarik.

3. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dispozitat kryesore të legjislacionit kombëtar që miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

4. Jo më vonë se data 1 janar 2007, Komisioni i paraqet Parlamentit European dhe Këshillit një raport mbi zbatimin e kësaj direktive dhe, sipas rastit, mbi nevojën për harmonizim të mëtejshëm. Raporti tregon se si i kanë përdorur Shtetet Anëtare mundësitë e kësaj direktive dhe, veçanërisht, nëse kompetencat diskrecionare të dhëna autoriteteve mbikëqyrëse kombëtare kanë rezultuar në diferenca të konsiderueshme në mbikëqyrjen e tregut të brendshëm.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 5

Të adresuarit

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 2 mars 2002.

Për Parlamentin European

Presidenti

P. COX

Për Këshillin

Presidenti

R. De Rato Y Figaredo

(1) GZ C 96 E, 27.3.2001, fq. 129.

[2] GZ C 193, 10.7.2001, fq. 16.

(3) Opinion i Parlamentit European, datë 4 korrik 2001 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit, datë 14 shkurt 2002.

[4] GZ L 228, 16.8.1973, fq. 3. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2000/26/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 181, 20.7.2000, fq. 65).

[5] GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2000/64/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 290, 17.11.2000, fq. 27).

[6] GZ L 374, 31.12.1991, fq. 32.

[7] GZ L 374, 31.12.1991, fq. 7.

[8] GZ L 374, 31.12.1991, fq. 32.

[9] GZ L 172, 4.7.1988, fq. 1. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2000/26/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 181, 20.7.2000, fq. 65).

[10] GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 2000/64/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (GZ L 290, 17.11.2000, fq. 27).